



Vendimi Nr.120/23

Datë: 18.12.2023

Në bazë të nenit 33, paragrafi 1.12 të nenit 55, paragrafit 1 të nenit 70, të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës si dhe në bazë të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 15 [Detyrimi për Njoftimin e Realizimit të Përqendrimit], nenit 17, paragrafi 1. 2 i nenit 22 [Masat pas Realizimit të Paligjshëm të Përqendrimit] dhe paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të nenit 57 (masat ndëshkuese për shkeljet të lehta të rregullave në konkurrencën e tregut) të Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës (Ligji i shfuqizuar me Ligjin nr.08/L-056) dhe nenit 11 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2018 mbi Kriteret për Shqiptimin e Masës së Sanksioneve Administrative,

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës lidhur me mos njoftimin e realizimit të Përqendrimeve, në vitet 2019 dhe 2021, me datën 18.12.2023, mori këtë:

VENDIM

- I. Me të cilin, konstatohet se Ndërmarrja MTS d.o.o., Dega në Kosovë, ka shkelur dispozitat e Ligjit nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-226, duke mos parashtruar kërkesën për njoftimin e detyruar për përqendrim për blerjen e 100% të aksioneve të ndërmartjeve: VGN NET d.o.o, LIKA d.o.o., P.P.RKDS-IMPULS, në emër të Ivan Radosavljevic B.I. dhe Herc International d.o.o.
- II. Ndërmarrjes MTS d.o.o., Dega në Kosovë, i shqiptohet masa e sanksionit administrativ, përkatësisht gjoba në shumën prej 1,563,959.26 € (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tremijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë euro e njëzet e gjashtë cent).
- III. Mjetet, nga masa ndëshkuese administrative, të transferohen në llogarinë bankare të buxhetit të Republikës së Kosovës, sipas afatit ligjor pas hyrjes në fuqi, të këtij vendimi.

IV. Obligohet, ndërmarrja MTS d.o.o, që për blerjet e potencuara në dispozitivin I të këtij vendimit, të paraqes kërkesë për përqendrim në Autoritet, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

ARSYETIM

Fillimi i Procedurës dhe ligji i zbatuar

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 33, 36 dhe 70 të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës ka filluar monitorimin e tregut duke u bazuar në shkrimet e botuara në mediat elektronike, rrjete sociale dhe burime zyrtare, të cilat janë siguruar nga Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (më tutje në tekst: ARKEP), lidhur me aktivitetet e operatorit/ndërmarrjes MTS D.O.O. (Mobil Telekom Srbije-me tutje në tekst: MTS) e cila ofron shërbime të telefonisë fikse, mobile, internetit dhe kabllor, në tregun gjeografik të Republikës së Kosovës. Autoriteti ka vendosur bazuar në dispozitat materiale të përcaktuara me Ligjin 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-226 i cili është zbatuar në këtë rast edhe pas shfuqizimit të tij, pasi që shkeljet kanë ndodhur në kohën kur ligji 03/L-229 (në vijim të tekstit: ligji i mëparshëm) ka qenë në fuqi. Po ashtu, detyrimi për njoftimin e përqendrimit ka qenë obligim edhe me Ligjin 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-226, ashtu siç është njëjtë edhe me Ligjin nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Procedura Hetimore e Ndjekur nga Autoriteti

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, ka vlerësuar raportin e shqyrtimit paraprak, me nr. Prot. 354/22-08/B, datë 29.11.2022, në tregun e telekomunikimeve - telefonisë fikse, mobile, internetit dhe kabllor, pas mbledhjes së informatave lidhur me dyshimet për transaksionet e realizuara, rrjedhimisht blerjes së aksioneve apo fitimit të kontrollit mbi ndërmarrjet tjera në tregun përkatës, për të cilat dyshohet se përmbushin detyrimin për paraqitje të Njoftimit për Përqendrim, bazuar në nenin 11,13 dhe 15 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, si dhe të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 15 [Detyrimi për Njoftimin e Realizimi të Përqendrimit] dhe nenit 22 [Masat pas Realizimit të Kundërligjshëm të Përqendrimit] dhe paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të nenit 57 (masat ndëshkuese për shkeljet e lehta të rregullave në konkurrencës së tregut) të Ligjit nr. 03/L-229 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës (Ligji i shfuqizuar me Ligjin nr.08/L-056 për mbrojtjen e konkurrencës).

- Autoriteti i Konkurrencës më datë 25.11.2022, ka nxjerrë Konkluzion për Fillimin e Procedurës Hetimore, me numër 53/2022, ndaj Ndërmarrjes MTS D.O.O. (Telekomi Mobil i Serbisë - Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar), me numër unik

identifikues: [REDAKTUAR] me adresë: Mitrovicë Veriore, Bošnjačka Mahala Oslobođenja Nr. 1, për shkak të dyshimeve të arsyeshme se e njëjta ka realizuar shitblerje të aksioneve me qëllim përfitimin e kontrollit mbi ndërmarrje të caktuara në tregun përkatës të Republikës së Kosovës për të cilat dyshohet se përmbushin detyrimin për paraqitje të Njoftimit për Përqendrim, bazuar në nenin 15 të Ligjit të mëparshëm, po ashtu edhe me nenin 11 dhe 13 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës,

- *Transaksionet kanë përmbushur detyrimin për paraqitjen e Njoftimit për Përqendrim sipas nenit 13 dhe nenit 15, të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.*
- *Bazuar në nenin 13 detyrimi për të kërkuar lejimin e përqendrimit i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, paragrafi citat: Pjesëmarrësit në përqendrim duhet t'i kërkojnë paraprakisht Autoritetit t'ua lejojë realizimin e përqendrimit të synuar nëse:*
 - *pjesëmarrësit në përqendrim kanë mbi njëzet (20) milionë euro qarkullim të përbashkët në tregun ndërkombëtar dhe njëri pjesëmarrës në përqendrim ka mbi një (1) milion euro qarkullim në tregun e brendshëm; ose*
 - 1.2. së paku dy pjesëmarrës në përqendrim kanë mbi tre (3) milionë euro qarkullim në tregun e brendshëm dhe Neni 2. Qarkullimi i pjesëmarrësve në përqendrim llogaritet sipas raporteve financiare të vitit financiar që i paraprin vitit të përqendrimit. Nëse parashtruesit nuk kanë arritur të mbyllin raportet financiare vjetore para se të parashtrojnë kërkesën për lejimin e përqendrimit, qarkullimi i pjesëmarrësve, llogaritet sipas raporteve financiare të vitit të fundit financiar për të cilin janë mbyllur raportet financiare.*

MTS, nuk ka parashtruar kërkesën për njoftimin e detyruar për përqendrim, bazuar në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-229 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës (në vijimësi të tekstit -ligji i mëparshëm).

Ndërmarrja MTS d.o.o. përmbushi në mënyrë komulative qarkullimin apo të hyrat e përcaktuara në paragrafin 1, nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2 të nenit 15 të ligjit të mëparshëm, sipas raporteve financiare që i paraprin vitit paraprak të përqendrimit duke pasur qarkullim, [REDAKTUAR] € (në vitin 2018) ¹, [REDAKTUAR] € (viti 2019) ²,

¹ 2018 - <https://www.telegroup-ltd.com/documents/files/company/finansijski-izve%C5%A1taji-2018-telegroupbeograd.pdf> - <https://www.exchange-rates.org/exchange-rate-history/rsd-eur-2018-12-31>;
² 2019- https://www.ratel.rs/uploads/documents/empire_plugin/5f364e98b4afb.pdf
<https://www.exchange-rates.org/exchange-rate-history/eur-rsd-2019-12-31>;

██████████ (viti 2020), ██████████ (viti 2021)³ dhe ██████████ (viti 2022)⁴

Palë në procedurë hetimore

- Duke u bazuar në Konkluzionin për Fillimin e Procedurës Hetimore, me numër 53/2022 datë 25.11.2023, Palë në këtë procedurë të zhvilluar nga Autoriteti i Konkurrencës, konsiderohet: - ndërmarrja MTS d.o.o. (Mobil Telekom Serbi).

Përcaktimi i tregut përkatës

Tregu përkatës, përcaktohet si treg i mallrave dhe shërbimeve të caktuara në një zonë gjeografike në të cilën, kryhet veprimtaria e ndërmarrjeve.

Duke u bazuar në nenet 3,4,5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ për Mënyrën dhe Kriteret e përcaktimit të tregut përkatës, numër 02/2018, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, përcakton se:

- **Tregu i produktit** - do të konsiderohen, Shërbimet e Telefonisë Mobile, Internet, Kabllor Optik, Shërbimet e Telefonisë Fikse dhe shpërndarja e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, të cilët operojnë me shërbimet e TV kabllore, në Republikën e Kosovës.
- **Tregu gjeografik** - do të konsiderohet, tregu i Republikës së Kosovës.

Tregu gjeografik përfshin zonën gjeografike, me të cilën ndërmarrjet marrin pjesë, me oferta ose blerje të produkteve. Për analizën e të gjitha dimensioneve të tregut, vëmendje e veçantë i kushtohet kushteve të qasjeve në treg, veçanërisht kostove të transportit, mundësive të qasjes në kanalet e shpërndarjes dhe kostove të lidhura me to, ndikimit të pengesave ligjore për hyrjen në treg, shprehive dhe zakoneve të konsumatorëve.

Autoriteti, me rastin e përcaktimit të tregut gjeografik pati parasysh se, kompania blerëse është aktive në territorin e Republikës së Kosovës, shtrirja gjeografike e shkeljes lidhet drejtpërdrejt dhe tërthorazi me të gjitha aktivitetet e kompanisë në Kosovë në tregun përkatës të produkteve dhe merr parasysh të gjitha të hyrat në Kosovë. Duke pasur parasysh se tregjet e telekomunikimeve elektronike dhe audiovizive (kabllor) për arsye të karakteristikave tek çështjet e marrjes së shërbimit, nga ana e kërkesës (shfrytëzuesve) të cilat nuk krijojnë shpenzime shtesë, sa i përket kalimit nga njëri operator tek tjetri, atëherë kur ka rritje të çmimit.

³ 2021- <https://mts.rs/Binarv/12328/Konsolidovani-godisnji-izvestaj-Telekom-Srbija-Grupe-2021.pdf>
<https://www.exchange-rates.org/exchange-rate-history/eur-rsd-2021-12-31>

⁴ 2022- https://www.nbs.rs/static/nbs_site/gen/latinica/58/regpien/PIEN_FIN_telekom.pdf
- <https://www.exchange-rates.org/exchange-rate-history/eur-rsd-2022-12-30>

Për shkak se shkelja është mos njoftimi i një përqendrimi në Kosovë, tregu përkatës gjeografik që preket është Kosova dhe duhet të përfshijë të gjitha aktivitetet e pjesëmarrësve të përqendrimit.

Autoriteti, më datë 30.12.2022, brenda afatit ligjor ka pranuar Komentet, nga ndërmarrja MTS d.o.o., me numër protokollit 398/22-01/H, ndaj “Konkluzionit”

Komisioni i Autoritetit pas shqyrtimit të të dhënave, vlerëson se:

Ndërmarrja MTS d.o.o., lidhur me kontratat për shitblerje të realizuara me operatorët tjerë në tregun përkatës, ka përbushur kushtin për përqendrim bazuar në nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të mëparshëm, për faktin se në vitin 2018 kishte realizuar të hyra prej [REDAKTUAR], ndërsa në vitin 2019 kishte pasur të hyra prej [REDAKTUAR], në vitin 2020 kishte pasur të hyra prej [REDAKTUAR] si dhe në vitin 2021 kishte pasur të hyra prej [REDAKTUAR].

Nga sa më lartë, Autoriteti konstaton se, ndërmarrja MTS d.o.o., ka realizuar transaksione/blerje, pa e dorëzuar njoftimin e detyrueshëm për qëllimin e përqendrimit i përcaktuar, sipas nenit 15 dhe 17 të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse nga të dhënat e siguruara nga pasqyrat financiare dhe kontratat e shitblerjes, për vitet e përqendrimit, përkatësisht qarkullimi për vitin paraprak të përfunduar, konstatojmë se “Pala”, kishte përbushur detyrimin për të parashtruar kërkesë për njoftim të përqendrimit pranë Autoritetit.

Për më tepër, realizimi i përqendrimit nga ndërmarrja MTS d.o.o. duke mos paraqitur kërkesë për përqendrim, ka bërë shkelje të dispozitave, të ligjit të mëparshëm dhe ka vazhduar veprimtarinë e saj, pa autorizim të përqendrimit nga Autoriteti, deri në marrjen e këtij vendimi. Andaj, MTS d.o.o. obligohet sipas pikës IV të dispozitivit të këtij vendimi, që për blerjet e potencuara në dispozitivin I të këtij vendimi, të paraqes kërkesë për përqendrim në Autoritet, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Më tutje, Autoriteti i Konkurrencës, ka ndjekur këtë procedurë:

Njoftimi për konstatimin e fakteve (Paraprake)

Autoriteti i Konkurrencës në mbështetje të nenit 46 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ndërmarrjes MTS d.o.o., më datë 24.04.2023 dhe me numër të protokollit 177/23-06/D i ka dorëzuar Njoftimin për Konstatimin e Fakteve.

Deklarata e ndërmarrjes MTS d.o.o. ndaj Njoftimit për Konstatimin e Fakteve

Ndërmarrja MTS d.o.o., brenda afatit ligjor, më datë 26.05.2023 me Numër të protokollit 234/23-01/H, ka ofruar Autoritetit, komentet dhe vërejtjet e saj, kundër Njoftimit për Konstatimin e fakteve (paraprake).

Njoftim për Konstatimin e fakteve

Autoriteti i Konkurrencës, bazuar në nenin 50 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, më datë 17.08.2023 me Prot Nr.384/23-08/D, ka dërguar "Palës" Njoftimin për Konstatimin e fakteve.

Seanca dëgjimore

Autoriteti, bazuar në nenin 48 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ka organizuar seancë dëgjimore, lidhur me rastin MTS d.o.o, me qëllim që, Ndërmarrja në hetim, të ketë mundësinë për të paraqitur informacionet apo provat e reja, bazuar në faktet që ka pranuar, lidhur me konstatimin e shkeljeve ligjore.

Në këtë seancë gjatë deklarimit të Sekretariatit të Autoritetit, u paraqitën të gjetura të reja, me të cilat u propozua që, ndërmarrja MTS d.o.o., i përket një grupi ndërmarrjesh të lidhura, është degë e Telekomit të Serbisë, me 100% të aksioneve.

Ndërkaq, ndërmarrja MTS d.o.o., ka kundërshtuar pretendimet e Autoritetit, njëjtë sikurse edhe në komentet e dërguara me shkrim kundër, Konkluzionit për Fillimin e Procedurës. Po ashtu, kundërshtimet ndaj Fakteve të Konstatuara në Procedurë (paraprake), me të cilat ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e Autoritetit. Ndërmarrja MTS d.o.o., gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, nuk ka paraqitur ndonjë fakt të ri, rrethanë të re, e cila eventualisht do të ndryshonte gjendjen faktike.

Të gjeturat dhe analiza e konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës, gjatë procedurës hetimore dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore konstatoj se ndërmarrja MTS d.o.o. kishte realizuar transaksionet për blerjen e 100% të aksioneve të këtyre, ndërmarrjeve:

1. Më datë 10.12.2019, përmes kontratës me Numër [REDAKTUAR] ndërmarrja MTS d.o.o. kishte realizuar transaksionin për blerjen e 100% të aksioneve me ndërmarrjen VGN NET d.o.o.
2. Më datë 10.12.2019 me Numër [REDAKTUAR] ndërmarrja MTS d.o.o. kishte realizuar transaksionin për blerjen e 100% të aksioneve me ndërmarrjen LIKA (IMPULS),
3. Me datë 10.12.2019 me Nr. [REDAKTUAR] ndërmarrja MTS d.o.o. kishte realizuar transaksionin për blerjen e 100% të aksioneve me ndërmarrjen P.P.,RKDS-

IMPULS të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës si Biznes Individual në emër të Ivan Radosavljevic B.I

4. Duke u bazuar në kontratën e datës, 22.03.2021 Numër [REDAKTUAR] kishte realizuar transaksionet për blerjen e 100% të aksioneve të ndërmarrjes HERC INTERNATIONAL d.o.o, sipas Pasqyrave Financiare të Veçanta dhe Raporti i Auditorit të Pavarur.

Duhet theksuar faktin se Autoriteti i Konkurrencës, ka zhvilluar një procedurë të vetme për të gjitha shkeljet (transaksionet) bazuar në nenin 84 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për shkak se gjendja faktike dhe baza juridike është e njëjtë, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, racionalitetit të kohës. Prandaj, çdo realizim i përqendrimit të ndërmarrjeve nga neni 13 i ligjit të mëparshëm, pjesëmarrësit e përqendrimit janë të detyruar ta njoftojnë Autoritetin, kur të plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 15 të Ligjit të mëparshëm për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Dështimi i ndërmarrjeve për të paraqitur kërkesën për Përqendrim pranë Autoritetit, sipas nenit 22 (masat pas realizimit të paligjshëm të përqendrimit) par.1.2, “ *përqendrimi realizohet pa e dorëzuar njoftimin e detyrueshëm për qëllimin e përqendrimit sipas nenit 17 të këtij ligji*”, pra të Ligjit të mëparshëm, konsiderohet si i paligjshëm. Rrjedhimisht Autoriteti bazuar në par. 1 nën-paragrafi. 1.1 të nenit 57 të ligjit të mëparshëm, shqipton masën e sanksionit administrativ (gjobën) e cila është deri [REDAKTUAR] të totalit të të hyrave që ndërmarrja ka realizuar në vitin e fundit, për të cilin është përfunduar raporti financiar, ndëshkohet ndërmarrja-pala në procedurë e cila; nëse Autoritetit nuk ia paraqet kërkesën për përqendrim.

Në paragrafin 1 të nenit 15 të ligjit të mëparshëm, përcakton se:

1. Me qëllim të marrjes së vendimit për lejimin e përqendrimit, sipas këtij ligji, pjesëmarrësit e përqendrimit janë të detyruar të paraqesin në Autoritet qëllimin e përqendrimit nëse në mënyrë kumulative janë përmbushur këto kushte:

1.1. të hyrat e konstatuar të ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku, në tregun ndërkombëtar janë më shumë se njëzet (20) milion Euro, sipas raporteve financiare të vitit financiar që i paraprinë vitit të përqendrimit, nëse së paku një pjesëmarrës ka selinë në Republikën e Kosovës;

1.2. të hyrat e përgjithshme të së paku dy (2) pjesëmarrës në përqendrim në tregun brendshëm të Kosovës, janë më shumë se tre (3) milionë Euro sipas raporteve financiar e që i paraprinë vitit të përqendrimit.

Ky nen i ligjit të mëparshëm, paragrafi 1.1 është ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ku shuma 100 milion euro ndryshohet në 20 milion euro (2014).

Me marrëveshjen për realizimin e bashkimit apo blerjes (Përqendrim) të aksioneve të ndërmarrjeve, në treg ka një konkurrent më pak, rrjedhimisht zvogëlohet konkurrenca në tregun përkatës, kështu që ndërmarrjet janë të detyruara të paraqesin njoftimin për Përqendrim pranë Autoritetit, për arsye të ndikimit ekonomik dhe vlerësimit juridik, respektivisht krijimit apo forcimit të Pozitës Dominuese, në tregun përkatës.

Me rastin e vlerësimit për arsyeshmërinë e marrjes së vendimit, Autoriteti merr parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht peshën e dëmit, që mund t'u paraqiten pjesëmarrësve të përqendrimit ose palëve të treta, si dhe efekteve të konkurrencës, që mund të lindin nga zbatimi i përqendrimit.

Mbrojtja dhe nxitja e konkurrencës

Vlerësimi i pasojave konkurruese, nuk është vetëm detyrë e vënë nga legjislacioni në fushën e Mbrojtjes së Konkurrencës por rrjedhë nga parimi i ekonomisë së tregut dhe nga liria ekonomike e garantuar drejtpërdrejtë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Integrimi i Kosovës dhe standardet, që dalin nga Rregulloret e Komisionit Evropian, që kërkohen të arrihen në këtë proces është një tjetër faktor përcaktues dhe nxitës për fushën e konkurrencës. Marrëveshja e Stabilizim Asocimit-MSA, Neni 74 dhe 75 i saj që prekin këtë fushë, shërbejnë si një katalizator për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të konkurrencës në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane.

Një mjedis konkurrues siguron se, do të ketë hyrës potencialë në “garë” për të prodhuar një produkt të ri apo për të ofruar një shërbim më të mirë. Si pasojë, konkurrenca e fuqishme përbën nxitësin kryesorë të rritjes së produktivitetit dhe siguron që tregu do të mbetet konkurrues, ngase, një mjedis konkurrues i mirëfilltë jep mundësi të zgjedhjes, shërbime më të mira, cilësi, çmimet konkurruese dhe produktet të reja (inovacion).

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, konstatoj se: Ndërmarrja MTS d.o.o., nuk ka parashtruar kërkesën për lejimin e përqendrimit edhe pse e njëjta ka përmbushur kushtin ligjor sipas nenit 15 të ligjit të mëparshëm si dhe nenit 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.2, dhe paragrafin 3 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Pra, ka shkelur dispozita materiale të ligjit të mëparshëm si dhe njëherazi ka vazhduar veprimtarinë e saj pa autorizim të përqendrimit.

Ndërmarrja MTS d.o.o., këto transaksione/blerje, i ka realizuar pa e dorëzuar njoftimin e detyrueshëm për njoftimin e përqendrimit të parashikuar në nenin 15 të Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-226 sepse nga të dhënat e siguruar nga pasqyrat financiare dhe kontratat e shitblerjes, për vitet e Përqendrimit, përkatësisht qarkullimi për vitin paraprak të përfunduar, konstatojmë se “Pala”, ka përmbushur kushtin për të parashtruar kërkesë, për njoftim të Përqendrimit, pranë Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës. Autoriteti i Konkurrencës i cili ka qenë i obliguar sipas ligjit, që të jetë aktiv për të gjitha format e parandalimit,

kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ndërmarrjet nëse këto veprime kanë efekte në treg.

Neni 64, paragrafi 1 i Ligjit të mëparshëm përcakton parashkrimin, si vijon:

1. *Komisioni nuk mund të filloj procedurat dhe shqiptimin e masave ndëshkuese pasi të kalojnë pesë (5) vjet nga dita e fillimit të shkeljeve, sipas këtij ligji.*

Pra, me Ligjin nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, është ndjekur procedura, ndërsa plotësimi i kriterëve apo dispozitat materiale janë zbatuar nga ligji i mëparshëm dhe njëherazi, shkeljet e konstatuara nuk janë parashkruar as sipas ligjit të mëparshëm si dhe Ligji në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës, përcakton se “1. Autoriteti mund të fillojë procedurë dhe të shqiptojë gjobë brenda afatit të parashkruar prej pesë (5) viteve nga dita e shkeljes së këtij ligji”.

Kalkulimi i Gjobës dhe Mënyra e Shqiptimit

Në mbështetje të nenit 57 par. 1 nën-paragrafi 1.1 dhe nenit 59 të ligjit të mëparshëm, në mbështetje të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2018 mbi Kriteret për Shqiptimin e masës së sanksioneve administrative, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, kalkulimin e sanksionit administrativ, e ka bërë në këtë mënyrë:

Komisioni konstaton se, shkelja ka filluar nga data 10.12.2019, me të cilën janë realizuar tri shitblerje mbi ndërmarrjet në tregun përkatës, po ashtu edhe në vitin 2021 kishte realizuar shitblerje mbi një ndërmarrje, Autoriteti konsideron se ky veprim konsiderohet shkelje sipas paragrafit 1.2 të nenit 22 të Ligjit të mëparshëm.

Autoriteti, ndërmarrjes MTS d.o.o, i shqipton gjobë në shumën prej: **1,563,959.26 €** (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tremijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë euro e njëzet e gjashtë cent) , për shqiptimin e gjobës. Përlllogaritja e gjobës është bërë ashtu që, për secilën nga shkeljet e konstatuara (transaksionet), është shqiptuar nga ●% e qarkullimit të përgjithshëm, të të hyrave të Ndërmarrjes MTS.d.o.o.

Qarkullimi, i ndërmarrjes, MTS d.o.o., për vitet e shkeljes është, si në vijim:

1. Me kontratën e datës 10.12.2019, ndërmarrja MTS d.o.o., ka blerë 100% të aksioneve mbi ndërmarrjen VGN Net d.o.o. dhe qarkullimi për vitin 2022, është ●⁰⁰ x ●% = ● euro.
2. Me kontratën e datës 10.12.2019 ndërmarrja MTS d.o.o., ka blerë 100% të aksioneve mbi LIKA d.o.o., dhe qarkullimi për vitet vitin 2022, është ●⁰⁰ x ●% = ● euro.
3. Me kontratën, e datës 10.12.2019 ndërmarrja MTS d.o.o., ka blerë 100% të aksioneve mbi ndërmarrjen, Ivan Radosavljeviq B.I. 100%, dhe qarkullimi për vitin 2022, është ●⁰⁰ x ●% = ● euro.

4. Me kontratën e datës 22.03.2021 ndërmarrja MTS d.o.o., ka blerë 100% të aksioneve mbi ndërmarrjen Herc International d.o.o. 100%, dhe qarkullimi për vitin 2022, është [REDACTED]⁰⁰ % = [REDACTED] euro.
- Gjoha për shkeljet e vërtetuara, është: [REDACTED] €
 - Rrethanat lehtësuese [REDACTED] në vlerë monetare: [REDACTED] €
 - Gjoha për pagesë (pas lehtësirave): 1.563.959.26 €

Komisioni, me rastin e caktimit të gjobës, mori për bazë si rrethanë lehtësuese, bashkëpunimin e Palës me Autoritetin gjatë procedurave hetimore si dhe ofrimin në kohë të të gjitha dokumenteve të kërkuara, për ti deponuar te Autoriteti.

Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 22 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-226, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, nga ana e Komisionit.

Obligohet Sekretariati, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.

Këshilla juridike: Kundër këtij Vendimi, nuk lejohet ankesa, por pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në gjykatën kompetente.

V E N D I M

AUTORITETI I KONKURRENCËS KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi-Loku
Anëtare



Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva